



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
GJ.P "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh. A. Prishtinë Biznes Planit për vitin 2026

Prishtinë, Nëntor 2025

N.P.L "Stacioni i Autobusëve" SH.A. - Prishtinë

Rr. Bill Clinton, p.n - Prishtinë / Republika e Kosovës
www.sap-rks.com contact@sap-rks.com
+383 (38) 551 333

PËRMBAJTJA

1	Përmbledhje Ekzekutive	3
2	Historia e ndërmarrjes.....	4
3	Vizioni.....	4
4	Misioni.....	5
5	SWot analiza e ndërmarrjes.....	5
6	objektivat e Planit Biznesit	6
6.1.	Objektivi 1. Shtimi i të Hyrave, për vitin 2026 në total për 26%	6
6.2.	Objektivi 2. Realizimi i investimeve	6
6.3.	Objektivi 3. Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ekzistuese në Stacion.....	6
6.4.	Objektivi 4. Përkujdesja për mirëqenjen e personelit.	6
6.5.	Objektivi 5. Rritja e qendrueshmërisë financiare.	7
7	Planifikimi i buxhetit financiar për vitin 2026	7
	Të hyrat.....	7
	Shpenzimet	8
	Investimet	8
	Amortizimi.....	9
	Të ardhurat NETO para tatimit	9
8.	Plani operativ mbi zbërthimin e objektivave për vitin 2026.....	10
8.1.	Objektivi i parë	10
8.1.1.	Sfida kryesore: Qiradhënia e hapësirave komerciale	10
8.1.2.	Rritja e të hyrave nga peronizimi.....	10
8.2.	Objektivi i dytë është realizimi i planit të investimeve	10
8.2.1.	Angazhimi i një kompanie profesionale për projektim dhe mbikëqyrje ndërtimore	11
8.3.	Objektivi i tretë është përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ekzistuese në Stacion.....	11
8.1.3.	Ndërtimi i INFO-Pool-it për qytetarët	11
8.1.4.	Renovimi i fasadës së jashtme.....	11
8.1.5.	Renovimi i tualetit publik.....	11
8.3.	Objektivi i katërt është përkujdesja për mirëqenjen e personelit.....	11
8.3.1.	Sigurimet shëndetësore	11
8.3.2.	Trajnimi dhe zhvillimi profesional	11
8.3.3.	Përmirësimi i kushteve të punës	12
8.3.4.	Dhënia e pagës së trembëdhjetë për vitin 2026.....	12
8.4.	Objektivi i katërt është rritja e qendrueshmërisë financiare.	12
8.4.1.	Optimizimi i kostove operative dhe administrative	12
9.	Burimet njerëzore	12
9.1.	Nevojat aktuale për personel.....	13
9.2.	Politika e kompensimit të stafit dhe matja e performances	13
9.2.1.	Kualifikimi shkollor i kërkuar për vendin e punës;	13
9.2.2.	Ndërlkueshmëria e punës, në raport me përgjegjësitë dhe sfidat që mbart pozita;	13
9.2.3.	Rëndësia e detyrës në kuadër të funksionimit të përgjithshëm të ndërmarrjes;	13
9.2.4.	Rrezikshmëria në vendin e punës, si faktor që ndikon në kompensimin shtesë;	13
9.2.5.	Kushtet dhe intensiteti i punës, që lidhen me mjedisin dhe ngarkesën e punës;	13
9.2.6.	Përvoja profesionale, e cila njihet si përparësi dhe vlerë e shtuar në sistemin e kompensimit.	13
9.3.	Ngjitja e mirëqenës së punëtorëve	13
10.	Anexi 1 Tabela e buxhetit për 2026	14
11.	Anexi 2 Tabela e pagave për vitin 2026.....	17
12.	Anexi 3 organogrami.....	21

1 Përmbledhje Ekzekutive

Plani i biznesit për vitin 2026 parasheh rritje të qëndrueshme të të hyrave operative dhe zgjerim të kapaciteteve operuese të ndërmarrjes, duke reflektuar një menaxhim më efikas të shërbimeve, dhe strategji të avancuara për komercializim të hapësirave dhe shërbimeve të Stacionit të Autobusëve të Prishtinës.

Plani i biznesit të Ndermarrjes Publike lokale mbështetet në bazën ligjore të përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Gjatë vitit 2026, ndërmarrja planifikon një rritje të ndjeshme të të hyrave operative, duke arritur vlerën prej 1,878,780.76 €, kundrejt 1,491,242.56 € të planifikuara në rishikim e buxhetit për vitin 2025.

Kjo rritje prej rreth 26% është rezultat i politikave dhe vendimeve të marra nga Bordi i Drejtoreve për ndryshimin e çmiorëse së shërbimeve të ndërmarrjes tonë dhe rritjes së volumit të shërbimeve të transportit.

Rritja mbështetet kryesisht nga kategoritë kyçe të të hyrave, përfshirë shërbimet e peronizimit, shërbimin e parkingut të automjeteve dhe autobuseve, qiradhënies, provizionimit dhe komisionimit, për biletat e udhëtarëve të cilat shënojnë rritje të vazhdueshme në vlerë dhe në pjesëmarrjen e tyre në strukturën e përgjithshme të të hyrave.

Kontributet kryesore sipas kategorive të të hyrave

a) Shërbimi i peronizimit mbetet burimi kryesor financiar i ndërmarrjes, me rritje prej **28%**, duke reflektuar menaxhim më efikas të proceseve operacionale.

b) Të hyrat nga qiradhënia shënojnë rritjen më të madhe përqindore, mbi **83%**, duke u bërë një ndër shtyllat kryesore të të ardhurave për vitin 2026, si rezultat i rritjes së kërkesës për hapësira komerciale dhe përmirësimit të kontratave të qirasë.

c) Të hyrat nga komisionimi dhe provizionimi tregojnë rritje stabile, duke ndikuar pozitivisht në diversifikimin e të hyrave të ndërmarrjes.

d) Të hyrat nga reklamat, garderoba dhe shërbimet dytësore kontribuojnë në rritjen e qëndrueshme të të hyrave, duke forcuar rolin e shërbimeve plotësuese në modelin e biznesit.

e) Të hyrat nga parkingu, tregojnë rritje stabile, duke ndikuar pozitivisht duke manifestuar pozitivitet ne ndrrimin e politikave tarifore te aprovuara paraprakisht nga Bordi i Drejtoreve.

Këto projeksione pasqyrojnë orientimin strategjik të ndërmarrjes drejt rritjes së qëndrueshme financiare, përmirësimit të infrastrukturës dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët dhe operatorët e transportit

2 Historia e ndërmarrjes

Ndërmarrja Shoqërore (NSH) Stacioni i Autobusëve, në Prishtinë, është themeluar në vitin 1977, nga fondet e Bankës Botërore të cilat u dhanë për shtetet e pazhvilluara. Kosova si njësi e ish shtetit të Jugosllavisë përfitoi nga kjo ndihmë.

Në vitin 1983 pas shpronësimeve që bëri Komuna e Prishtinës u vendos që Stacioni i Autobusëve të vendoset në hapësirat ekzistuese të sotme.

Pas përfundimit të luftës, në vitin 1999, ndërmarrja është administruar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM). Në ndërkohë, në vitin 2015 është transformuar në ndërmarrje publike komunale, si shoqëri aksionare me Kuvendin Komunal (KK) të Prishtinës, si pronar të vetëm të ligjshëm të të gjitha aksioneve të ndërmarrjes. Në këtë kontekst, KK i Prishtinës ushtron kompetencat dhe përgjegjësitë e parapara me ligjet në fuqi, por edhe me Statut dhe akte të tjera nënligjore të Ndërmarrjes.

Ndërmarrja realizon të hyra vetanake dhe nuk varet nga buxheti komunal. Burimet kryesore të hyrave janë shërbimi i peronizimit (pranimi dhe përcjellja e autobusëve), shërbimi i shitjes së biletave për operatorët e transportit, shërbimi i ruajtjes së bagazhit të udhëtarëve, shërbimi i parkingut, shërbimi i poligoneve për auto shkolla, qiradhënia e lokaleve afariste në pronësi të Stacionit.

Si rrjedhojë, NPL Stacioni i Autobusëve Sh. A. Prishtinë planifikon të mbetet një qendër e rëndësishme e ofrimit të shërbimeve për klientët e vetë të shumtë, qofshin ata vendorë ose ndërkombëtarë.

3 Vizioni

NPL Stacioni i Autobusëve sh.a. – Prishtinë synon të jetë pikë referuese për transportin e udhëtarëve, duke u pozicionuar si një qendër moderne, konkurruese në nivel rajonal dhe atraktive për të gjithë përdoruesit e shërbimeve. Objektivi kryesor është ofrimi i shërbimeve të qasshme, të pranueshme dhe në kushte të mira, gjithmonë në funksion të plotësimit të kërkesave të konsumatorëve dhe maksimizimit të të ardhurave.

Vizioni afatgjatë i ndërmarrjes është që në vazhdimësi të ofrojë shërbime cilësore për publikun dhe klientët, duke ndërtuar një qëndrueshmëri të fortë financiare. Këto dy elemente – cilësia dhe qëndrueshmëria – janë thelbësore për zhvillimin dhe modernizimin e mëtejshëm të Stacionit të Autobusëve, i cili, krahas aeroportit ndërkombëtar, përfaqëson një nga pikat kryesore të hyrje-daljeve në dhe nga Kosova.

Si rezultat, ndërmarrja planifikon të mbetet një qendër e rëndësishme për ofrimin e shërbimeve për një gamë të gjerë klientësh, vendorë dhe ndërkombëtarë. Planifikimi strategjik për modernizim dhe zhvillim është tashmë në proces, ndërsa në të ardhmen e afërt do të fillojë edhe implementimi konkret i projekteve të shumta, të cilat synojnë të zgjerojnë dhe përmirësojnë gamën e shërbimeve – qoftë ato fizike apo digjitale.

Përmes këtyre investimeve dhe risive, Stacioni i Autobusëve pritet të njohë rritje të qëndrueshme të të hyrave, si dhe përmirësim të dukshëm të imazhit të ndërmarrjes, të Kryeqytetit dhe të vendit në tërësi.

4 Misioni

Misioni i NPL Stacioni i Autobusëve sh.a. - Prishtinë është të ofrojë shërbime cilësore, të drejta dhe të qasshme për të gjithë pasagjerët që shfrytëzojnë shërbimet e stacionit, për bizneset që operojnë brenda hapësirave të ndërmarrjes, si dhe për operatorët e ndryshëm të transportit që veprojnë nga apo përmes Stacionit të Autobusëve në Prishtinë.

Përmes ngritjes së vazhdueshme të cilësisë së shërbimeve dhe efikasitetit operacional, ndërmarrja synon të rrisë të hyrat dhe të krijojë një strukturë të qëndrueshme financiare, duke u konsoliduar si një ndërmarrje publike komunale moderne dhe funksionale, në shërbim të qytetarëve dhe zhvillimit të Kryeqytetit.

5 SWOT analiza e ndërmarrjes

Përparësitë • Infrastrukturë solide për ofrimin e shërbimeve. • Kushte dhe lokacion i përshtatshëm për operim dhe qasje të lehtë për udhëtarët. • Hapësirë e mjaftueshme për zgjerim të kapaciteteve dhe zhvillim të shërbimeve të reja. • Stacioni i vetëm në Republikën e Kosovës me licencë të kategorisë "A". • Fuqi punëtore e mjaftueshme për mbulimin e nevojave operationale. • Ofrim i shërbimeve cilësore dhe profesionalizëm në menaxhim.	Dobësitë • Mungesë e pajisjeve dhe teknologjisë moderne të TI-së. • Njohuri të kufizuara dhe mungesë trajnimi profesional në fushën e TI-së dhe finacave për stafin. • Borxhe të trashëguara nga periudhat e kaluara që rëndojnë buxhetin aktual. • Kapacitete të limituara në përpilimin e kërkesave specifike teknike për investimet kapitale. • Mosha e lartë e një pjese të punonjësve që mund të ndikojë në efikasitetin dhe përshtatshmërinë me teknologjitë e reja.
Mundësitë • Potencial për rritje të të hyrave përmes zhvillimit të shërbimeve ekzistuese dhe të reja. • Shfrytëzim më efikas i hapësirave të mëdha të parkingut për gjenerim të të hyrave shtesë. • Mundësi për zhvillimin e shitjes dhe rezervimit të biletave online. • Koordinim me institucionet relevante për respektimin e rregullave të nisjes dhe rendit të udhëtimit nga SAP. • Harmonizim i çmimeve të peronizimit në përputhje me licencën e kategorisë "A" dhe standardet e stacioneve rajonale. • Mundësi për shitjen e biletave për të gjitha nisjet nga SAP në një sistem të centralizuar. • Potencial për zhvillim të shërbimeve shtesë dhe bizneseve të tjera mbështetëse në ambientet e SAP. • Mundësi për të rritur motivimin dhe përfshirjen e punonjësve përmes masave stimuluese..	Rreziqet • Operimi i paligjshëm i operatorëve të pa licencuar, që dëmton konkurrencën e ndershme. • Moszbatimi i rregulloreve ligjore nga operatorët transportues për përdorimin e peronëve të SAP. • Rreziku nga dështimi i sistemit të menaxhimit të biletave dhe të dhënave (softuerik). • Rreziku nga sulmet kibernetike që mund të rezultojnë me humbje të të dhënave me rëndësi të lartë për ndërmarrjen.

6 Objektivat e Planit Biznesit

Menaxhmenti, përmes këtij plani, ka paraqitur një qasje ambicioze zhvillimore, duke përcaktuar objektiva të qarta dhe të matshme, të strukturuar sipas afateve kohore për realizim:

6.1. Objektivi 1. Shtimi i të Hyrave, për vitin 2026 në total për 26%.

Ky objektivi, nëse krahasohet sipërfaqësisht me vitin paraprak, mund të krijojë përshtypjen e një mospërputhjeje ekonomike. Megjithatë, rritja e parashikuar është plotësisht e justifikuar dhe e mundur nga vendimet e Bordit të Drejtorëve për ndryshimin e çmimoreve të shërbimeve, si dhe rishikimi i kushteve të qiradhënies.

6.2. Objektivi 2. Realizimi i investimeve.

Për vitin 2026, menaxhmenti ka planifikuar investime në gjithsej 23 projekte, me vlerë totale prej 436,150.00€. Këto investime paraqesin orientimin strategjik të ndërmarrjes drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe modernizimit. Investimet janë të strukturuar në tri drejtime kryesore:

1. Zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese për pritjen dhe përcjelljen e udhëtarëve, me synim rritjen e të hyrave financiare, përfshirë ndërtimin e kapaciteteve të reja të parkingut me 100 sllote parkimi shtesë.
2. Përmirësimi i kushteve dhe i përvojës së shfrytëzuesve të shërbimeve, përmes investimeve infrastrukturore.
3. Investimi në pajisje dhe sisteme të teknologjisë informative, me qëllim rritjen e efikasitetit operacional dhe kontrollit të brendshëm.

Tabela e plotë me projektet konkrete është e paraqitur në vijim të dokumentit.

6.3. Objektivi 3. Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ekzistuese në Stacion.

Fokus i menaxhmentit do të jetë përmirësimi i shërbimeve për shfrytëzuesit e shërbimeve tona. Kjo nevojë është shëndrruar në objektivi me qenë se, ndër vite nuk është investuar në këtë drejtim. Gjithashtu, nga analizimi i raportit të knaqshërisë së klienteve. Sipas buxhetit është planifikuar investim në:

1. Ndërtimin i info pulltit në qendër të salles i cili do të ndikojë në informim të qytetarëve për nevojat e tyre.
2. Renovim i toaletit publik
3. Renovim i fasadës së ndërtesës
4. Nëpërmjet web faqes dhe LED ekranit gjigat të blere në vitin 2025 do të vendoset itinerati i nisjeve nga Stacioni i Autobusëve.

6.4. Objektivi 4. Përkujdesja për mirëqenjen e personelit.

Menaxhmenti konsideron se, personeli i një ndërmarrjeje është aset kryesor që organizata e posedon, andaj në kuader të këtij objektivi menaxhmenti ka planifikuar buxhet për ngritjen e mirëqenjes së punëtorëve dhe kushteve më të mira të punës duke planifikuar buxhet në katër sfera:

1. Sigurime shëndetësore për të gjithë punëtorët e ndërmarrjes.
2. Furnizim me inventar dhe pajisje për personelin.
3. Sigurimin e trajnimeve të personelit.
4. Dhënia e pagës së trembëdhjetë në muajin dhjetor 2026

6.5. Objektivi 5. Rritja e qendrushmerise financiare.

Menaxhmenti e konsideron të rëndesishë së veçant ketë objektivi. Rritja e qendrushmërisë financiare është planifikuar nëpërmjet optimizimit të kostove operative dhe atyre administrative, duke i zbritur ato për rreth 17% në raport me vitin paraprak.

7 Planifikimi i buxhetit financiar për vitin 2026

Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë (në vijim: SAP) ka hartuar planifikimin buxhetor financiar për vitin 2026, duke u bazuar në analizat e performancës, aktivitetet dinamike të realizuara gjatë vitit aktual 2025 si dhe në bazë të analizës së impaktit financiarë që kanë pas vendimet e bordit të drejtorëve për ndryshimin e çmimeve të shërbimeve, peronizim, parking dhe çmimeve të qirasë së lokaleve. Ky biznes plan synon vazhdimin e zhvillimit progresiv të ndërmarrjes në përputhje me objektivat të cilat janë shpalosur në vijim të dokumentit si , investimet e planifikuara dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve për qytetarët dhe palët e interesit. Të dhënat financiare janë të paraqitura në mënyrë të strukturuar përmes tabelave buxhetore që përfshijnë:

Të hyrat e planifikuara, Shpenzimet operative dhe administrative pagat për personelin, si dhe Investimet kapitale të parashikuara për vitin 2026.

Secila nga vijat buxhetore shoqërohet me përshkrime të detajuara dhe sqarime për llogaritjet e realizuara, duke mundësuar transparencë, qartësi dhe logjikë financiare në procesin e planifikimit.

Të hyrat

NPL "Stacioni i Autobusëve", sh.a. Prishtinë (në vijim: SAP) është ndërmarrje publike komunale, e themeluar me qëllim të ofrimit të shërbimeve publike në fushën e transportit të udhëtarëve.

SAP gjeneron të hyrat përmes shitjes së shërbimeve të ndryshme që ofron, të cilat janë të listuara në tabelën e mëposhtme s'bashkua me pjesëmarrjen e produkteve në buxhetin total të të hyrave

#	I - TË HYRAT	2025	2026
1	Të hyrat nga shërbimi i peronizimit	€ 769,877.98	€ 990,536.19
2	Të hyrat nga qiradhënja	€ 209,909.88	€ 385,398.61
3	Të hyrat nga provizionimi	€ 12,505.93	€ 15,000.00
4	Të hyrat nga Komisionimi	€ 46,520.76	€ 50,454.55
5	Të hyrat nga shërbimi i garderobës	€ 2,411.44	€ 3,207.55
6	Të hyrat nga reklama	€ 6,101.70	€ 9,000.00

7	Të hyrat nga shërbimi i parkingut	€ 443,914.87	€ 421,936.86
8	Te Hyrat e jashtzakonshme	€ -	€ 3,247.00
Totali i të hyrave operative (1-8)		€ 1,491,242.56	€ 1,878,780.77

Tabela nr. 1. Paraqitja e të hyrave dhe pjesëmarrja e shërbimeve në buxhetin total të të hyrave për vitin 2026 duke i karahasuar ato me vitin paraprak

Planifikimi i të hyrave është realizuar duke u bazuar në të dhënat e analizuara nga sistemi i kontabilitetit për tre tremujorët e parë të vitit 2025, si dhe duke aplikuar një objektiv financiar prej 5% rritje të të hyrave për vitin 2026.

Ky objektiv është vendosur në përputhje me politikat e Bordit të Drejtorëve dhe me trendet historike të performancës së ndërmarrjes. Të gjitha shërbimet e ofruara synojnë përmbushjen e kërkesave të udhëtarëve dhe operatorëve të transportit, duke kontribuar njëkohësisht në qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjes dhe zhvillimin e saj të mëtejshëm.

Shpenzimet

Në kategorinë e shpenzimeve janë përfshirë të gjitha kostot operative dhe administrative të ndërmarrjes, duke përfshirë edhe pagën e trmbëdhjetë, shtesat e kompensimit dhe sigurimet shëndetësore për punëtorët e ndërmarrjes. Shpenzimet janë planifikuar duke u bazuar në nevojat reale të funksionimit të SAP, obligimet ligjore dhe objektivat strategjike të ndërmarrjes për përmirësim të kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve publike.

Për vitin 2026, shpenzimet totale planifikohen të arrijnë në 1,513,416.07€, krahasuar me 1,322,852.24 € të planifikuara për vitin 2025. Rritja e shpenzimeve për rreth 14% reflekton:

#	2025	2026
Shpenzimet	€ 1,322,852.24	€ 1,513,416.07

Tabela nr. 2. Paraqitja e shpenzimeve për vitin 2026 duke i karahasuar ato me vitin paraprak

Investimet

Gjatë vitit 2026, Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë ka planifikuar një sërë investimesh kapitale me qëllim përmirësimin e infrastrukturës, rritjen e sigurisë, efikasitetit operacional dhe modernizimin e shërbimeve. Investimet e parapara janë të orientuara drejt rritjes së cilësisë së shërbimit për operatorët e transportit dhe qytetarët, si dhe synojnë të sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm të asetëve të ndërmarrjes.

Investimet e planifikuara për vitin 2026 arrijnë vlerën totale prej 1,334,650.00 €, të detajuara si më poshtë:

Investimet detaje për vitin 2026													
#	Emertimi	Vlera Financiare	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershore	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor
1	Investimi ne ndertimin dhe regullimin e peroneve	80,000.00					8,000.00	8,000.00	20,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	
2	Sistemi softwerik per kontrollin e rendit te udhimeve	5,000.00			5,000.00								
3	Furnizimi me UPS	1,000.00	1,000.00										
4	Furnizimi me mjete te teknologjise informative	20,000.00	2,000.00				8,000.00						
5	Pajise monitoruese (Kamera)me elemente perçelless	1,000.00		1,000.00									
6	Renovimi i tualetit publik	20,000.00									5,000.00	15,000.00	
7	Karrige Tavoline dhe inventar te zyrës	5,000.00				5,000.00							
8	Ndertimi i INFO-Peol ne Heli Komplet	10,000.00						10,000.00					
9	Furnizim me karrige ne holl	5,000.00					5,000.00						
10	Mbulimi metalik i hyrje-dalje tek porta (2 copa- 20.000) tek zbrazja e udhetareve dhe i gjenerato rit nga jashte	59,950.00								59,950.00			
11	Kabina te pagesave	11,000.00	11,000.00										
12	Blerja dhe montim i shtyllave elektrike per ndricim te jashtem	12,000.00									12,000.00		
13	Traktor per koqjen e bari	3,000.00			3,000.00								
14	Mjetet e vogla pune per gjetberim - Inventari i imet	800.00		800.00									
15	Sistemi i ujitjes pik pik dhe hapja e nje pusi per nevoja te mirembajtjes se qelberimit	8,000.00		8,000.00									
16	Investimet ne instalimin e rrymes, ndricimit dhe zerimit te peronat e ri	4,900.00								4,900.00			
17	Laminat	2,000.00											2,000.00
18	Renovimi i fasades se jashtme	5,000.00							5,000.00				
19	Mbulimi i 5 perone ne ri	30,000.00										30,000.00	
20	Renovimi i asfaltit te demtuar	5,000.00				5,000.00							
21	Renovimi i zyrës se koordinatoreve	3,000.00											3,000.00
22	Ndertimi i 100 slioteve te reja te parkimit per automjete	10,000.00			5,000.00	10,000.00			25,000.00	30,000.00	30,000.00		10,000.00
23	Blerja e Makinave/Mekineve per Numezim dhe Kordonedhave dhe monedhave	1,500.00		1,500.00									
Total		438,500.00	27,000.00	11,300.00	33,000.00	20,000.00	28,000.00	25,000.00	60,000.00	104,850.00	67,000.00	55,000.00	10,000.00

Tabela nr. 3. Paraqitja e investimeve

Amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin 2026 kapin vlerën 21,318.44 €. Zhvlerësimi i aseteve bëhet në përputhje me legjislacionin për pasuritë jo-qarkulluese, duke u bazuar në metodologjinë standarde të kategorizimit të aseteve sipas natyrës dhe jetëgjatësisë së tyre.

Ndërmarrja aplikon tre kategori të zhvlerësimit:

0% (Zhvlerësim zero) – për tokën, e cila nuk i nënshtrohet amortizimit;

5% (Klasa I) – për ndërtesat dhe strukturat përkatëse;

20% (Klasa II) – për pajisjet, inventarin teknik dhe asetet e tjera me jetëgjatësi të shkurtër.

Të gjitha asetet që i nënshtrohen zhvlerësimit kanë jetëgjatësi më të gjatë se një vit, duke u klasifikuar si pasuri jo-qarkulluese.

Të ardhurat NETO para tatimit

Të dhënat financiare të prezantuara në tabelën e mëposhtme dëshmojnë se ndërmarrja po lëviz drejt një faze të qëndrueshmërisë së lartë financiare, me kapacitet të shtuar për të gjeneruar të ardhura, për të mbuluar shpenzimet operative dhe për të krijuar hapësirë financiare për investime kapitale në funksion të qytetarëve dhe zhvillimit urban.

Analiza tregon një përmirësim të dukshëm të performancës financiare ndërmjet vitit 2025 dhe planifikimit për vitin 2026, veçanërisht në rritjen e fitimit operativ dhe të fitimit para tatimit.

#	Pershkrimi	Rishiki i buxhetit 2025	Buxheti 2026	%
1	Totali i të hyrave operative	€ 1,491,242.56	€ 1,878,780.76	26%
2	Total Shpenzimet	€ 1,322,852.24	€ 1,553,623.64	14%
3	Fitimi operativ para Zhvlerësimit	€ 168,390.32	€ 365,364.69	117%
4	Amortizimi-Shpenzimet e zhvlerësimit	€ 21,318.44	€ 21,318.44	0.0%
5	Fitimi/Humbja para të Tatimit	€ 147,071.88	€ 344,046.25	135%

Tabela nr. 4. Paraqitja e Fitimi para të Tatimit

1,553,623.64 €

8. Plan operativ mbi zbërthimin e objektivave për vitin 2026

8.1. Objektivi i parë i planit të biznesit për vitin 2026 ka theks të qartë financiar dhe synon rritjen e të hyrave totale operative me **26%** krahasuar me vitin paraprak. Ky objektivi mbështetet kryesisht në performancën e dy kategorive kryesore të të hyrave të ndërmarrjes:

- Të hyrat nga peronizimi:
769,877.98 € → 990,536.19 € (+28.65%)
- Të hyrat nga qiradhënia:
209,909.88 € → 385,398.61 € (+83.49%)

8.1.1. Sfida kryesore: Qiradhënia e hapësirave komerciale

Për të realizuar këtë objektivi, sfida më e madhe për menaxhmentin mbetet rritja e të hyrave nga qiradhënia, pasi vlera e planifikuar për vitin 2026 është bazuar në shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të lokaleve afariste.

Kjo nënkupton:

- Vazhdimin e ankandëve më të shpeshta për nxjerrjen në qira të hapësirave të lira;
- Shqyrtimin e mundësisë për angazhimin e një subjekti profesional të qiradhënies për menaxhimin komercial të hapësirave;

8.1.2. Rritja e të hyrave nga peronizimi

Për rritjen e të hyrave nga peronizimi, menaxhmenti planifikon:

- Intensifikimin e takimeve me inspektorët e MMPHI-së;
- Mbikëqyrje më rigoroze të orareve dhe rendit të udhëtimit;
- Ndërhyrje për respektimin e linjave ku ka devijime, përfshirë relacionet:
 - o Prishtinë-Mitrovicë
 - o Prishtinë-Podujevë
 - o Prishtinë-Orllan, të cilat aktualisht nuk po respektohen plotësisht.

Rregullimi i këtyre problemeve do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e të hyrave nga peronizimi, duke siguruar qarkullim më të lartë dhe të qëndrueshëm të operatorëve.

8.2. Objektivi i dytë është realizimi i planit të investimeve

Objektivi i dytë i planit të biznesit ka në fokus realizimin e plotë të planit investiv të paraparë për vitin 2026, siç është prezantuar në paragrafin e gjashtë të dokumentit. Menaxhmenti ka planifikuar një buxhet të dedikuar për investime kapitale, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës, modernizimit të shërbimeve dhe rritjes së cilësisë së operimit të ndërmarrjes.

Për realizimin e këtij objektiivi, janë përcaktuar dy drejtime kryesore veprimi:

8.2.1. Angazhimi i një kompanie profesionale për projektim dhe mbikëqyrje ndërtimore

- Për të siguruar zhvillim cilësor dhe për të garantuar që projektet e infrastrukturës (përfshirë rregullimin e peronave, ndriçimin e jashtëm, ndërtimin e slotëve të rinj të parkimit dhe investime të tjera ndërtimore) realizohen sipas standardeve teknike dhe afateve të përcaktuara, ndërmarrja do të angazhojë një kompani profesionale të projektimit dhe mbikëqyrjes ndërtimore. Kjo kompani do të përgatisë projektet ekzekutive, dokumentacionin teknik dhe do të monitorojë zbatimin e të gjitha punimeve kapitale.

Plani dinamik i realizimit të investimeve është detajizuar tek tabela e investimeve.

8.3. Objektivi i tret është përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve ekzistuese në Stacion

Objektivi i tretë i planit të biznesit ka në qendër përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ekzistuese në Stacionin e Autobusëve të Prishtinës, përmes investimeve infrastrukturore dhe rritjes së standardeve të operimit.

Pas finalizimit të procedurave teknike dhe pranimit të projekteve nga kompanitë profesionale të angazhuara, menaxhmenti planifikon të fillojë menjëherë zbatimin e një sërë projektesh të rëndësishme që do të ndikojnë drejtpërdrejt në përvojën e qytetarëve:

8.1.3. Ndërtimi i INFO-Pool-it për qytetarët

- Ndërtimi i pikës së informatave (INFO-Pool) synon të krijojë një hapësirë funksionale dhe moderne për ofrimin e informatave të sakta, shpejta dhe të aksesueshme për udhëtarët. Ky investim do të rrisë transparencën dhe efikasitetin e komunikimit me publikun.

8.1.4. Renovimi i fasadës së jashtme

- Përmirësimi i pamjes së jashtme të objektit është një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të stacionit dhe krijimit të një ambienti tërheqës dhe të sigurt për qytetarët. Ky projekt ndikon edhe në imazhin publik dhe në perceptimin e qytetarëve për shërbimet komunale.

8.1.5. Renovimi i tualetit publik

- Renovimi i tualetit publik paraqet një domosdoshmëri për rritjen e higjienës, komoditetit dhe standardeve të shërbimit për të gjithë udhëtarët dhe vizitorët e hapësirës. Projekti krijon kushte të dinjitetshme dhe kontribuon në rritjen e kënaqshmërisë së përdoruesve. Sipas planifikimeve fillestare dhe dinamikës së buxhetit, të gjitha këto investime pritet të përfundojnë deri në muajin qershor 2026

8.3. Objektivi i katërt është perkujdesja për mirëqenjen e personelit.

Objektivi i katërt i planit të biznesit përqendrohet në forcimin e mirëqenies, motivimit dhe kapacitetit profesional të stafit të NPL "Stacioni i Autobusëve". Menaxhmenti ka planifikuar një paketë të dedikuar masash që synojnë krijimin e një ambienti më të sigurt, më stabil dhe më profesional të punës. Për realizimin e këtij objektivi, janë paraparë investime në katër drejtime kryesore:

8.3.1. Sigurimet shëndetësore

- Për herë të parë në historinë e ndërmarrjes, do të implementohet sistemi i sigurimeve shëndetësore për të gjithë të punësuarit. Ky hap rrit sigurinë sociale të stafit dhe kontribuon në uljen e stresit dhe pasigurisë së punonjësve.

8.3.2. Trajnimi dhe zhvillimi profesional

- Janë planifikuar trajnime të specializuara për stafin në tre fusha thelbësore:
 - o Financa, kontabilitet dhe certifikim i dokumenteve financiare
 - o Teknologji të informacionit (IT)

o Sigurimi fizik

- Trajnimet synojnë rritjen e efikasitetit të shërbimeve dhe profesionalizimin e mëtejshëm të punonjësve.

8.3.3. Përmirësimi i kushteve të punës

- Furnizim me pajisje të reja IT, inventar zyrtar (karrige, tavolina) dhe mjete të tjera të domosdoshme për kryerjen e detyrave.
- Furnizim me dy baraka të reja për punëtorët e mirëmbajtjes dhe ekipet operative në terren.
- investime pritet të përfundojnë deri në muajin qershor 2026

8.3.4. Dhënia e pagës së trembëdhjetë për vitin 2026

Në funksion të ngritjes së mirëqenies së punëtorëve dhe me qëllim të stimulimit të tyre, në ndërmarrje, për herë të parë, është planifikuar dhënia e pagës së trembëdhjetë në muajin dhjetor të vitit 2026. Kjo është mundësuar falë politikave të qëndrueshme financiare dhe menaxheriale të ndërmarrjes.

8.4. Objektivi i katert është rritja e qendrueshmërisë financiare.

Menaxhmenti e konsideron të një rëndësie të veçantë forcimin e qëndrueshmërisë financiare të ndërmarrjes, si një ndër objektivat kyç të vitit 2026. Ky objektivi pritet të arrihet përmes dy qasjeve strategjike:

8.4.1. Optimizimi i kostove operative dhe administrative

- Parashihet zvogëlimi i kostove operative dhe administrative me rreth 17% krahasuar me vitin 2025.

9. Burimet njerëzore

NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë aktualisht punëson gjithsej 99 punëtorë, prej të cilëve 60 meshkuj dhe 39 gra. Mosha mesatare e stafit është 45.84 vjeç, duke reflektuar një forcë punëtore me përvojë të akumuluar dhe kapacitete profesionale të qëndrueshme.

Kualifikimi	Totali
Master (sistemi një vjeçar dhe dy vjeçar)	18
Fakulteti (studime katër vjeçare)	4
Bachelor (studime themelore trevjeçare)	21
Shkollë e lartë	1
Shkollë e mesme	51
Punëtorë të kualifikuar (aftësim profesional)	2
Punëtorë të pakualifikuar (shkolla fillore)	2
Totali i punëtoreve	99

9.1. Nevojat aktuale për personel

Për realizimin e objektivave strategjike të vitit 2026 dhe në përputhje me Rregulloren për organizim të brendshëm, ndërmarrja duhet të plotësojë dy pozita të cilat do të mbeten vakante për shkak të pensionimit të punonjësve aktualë:

1. Arkivist, në muajin shkurt 2026
2. Koordinator i Shërbimit Teknik, në muajin prill 2026

Ndërmarrja vazhdon të operojë sipas organogramit të miratuar, i cili është paraqitur në Aneksin 5 të këtij Plani të Biznesit.

9.2. Politika e kompensimit të stafit dhe matja e performances

Në funksion të modernizimit të politikave të Burimeve Njerëzore dhe për të siguruar një sistem të drejtë e të motivueshëm të kompensimit, NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë ka miratuar një rregullore për kompensimin e stafit.

Rregullorja mbi pagat dhe kompensimet e tjera çeshtjen e koeficientit të pages për të gjithë të punësuarit e ka të rregulluar sipas nenit 3 të rregullorës në fjale dhe atë, sipas kriterëve si në vijim:

- 9.2.1. Kualifikimi shkollor i kërkuar për vendin e punës;
- 9.2.2. Ndërlikueshmëria e punës, në raport me përgjegjësitë dhe sfidat që mbart pozita;
- 9.2.3. Rëndësia e detyrës në kuadër të funksionimit të përgjithshëm të ndërmarrjes;
- 9.2.4. Rrezikshmëria në vendin e punës, si faktor që ndikon në kompensimin shtesë;
- 9.2.5. Kushtet dhe intensiteti i punës, që lidhen me mjedisin dhe ngarkesën e punës;
- 9.2.6. Përvoja profesionale, e cila njihet si përparësi dhe vlerë e shtuar në sistemin e kompensimit.

9.3. Ngritja e mirëqenës së punëtorëve

Bordi i Drejtorëve, përmes aprovimit të këtij Plani të Biznesit, ka miratuar edhe propozimin për mbulimin e sigurimit shëndetësor për të gjithë të punësuarit në NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë, në vlerë prej 30,600.00 €. Ky vendim pasqyron angazhimin e ndërmarrjes për kujdes ndaj mirëqenies së stafit, duke e konsideruar atë një komponent të rëndësishëm për rritjen e motivimit dhe performancës së përgjithshme të punonjësve

10. Anexi 1 Tabela e buxhetit për 2026

Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2026 vs 2025				
Kategoritë (Zërat) e të hyrave dhe shpenzimeve		Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2025	Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2026	
#	Sektor i	I - TË HYRAT	-	Euro (€)
1	A	1. Të hyrat nga sherbimi i peronizimit	769,877.98	990,536.19
2		2. Të hyrat nga qiradhënja	209,909.88	385,398.61
3		3. Të hyrat nga provizionimi	46,520.76	50,454.55
4		4. Të hyrat nga Komisionimi	12,505.93	15,000.00
5		5. Të hyrat nga sherbimi i gardërobës	2,411.44	3,207.55
6		6. Të hyrat nga reklama	6,101.70	9,000.00
7		7. Të hyrat nga sherbimi i parkingut	443,914.87	421,936.86
8		8. Të Hyrat e jashtzakonshme	-	3,247.00
		Totali i të hyrave operative (1-8)	1,491,242.56	1,878,780.76
	B	Totali i të hyrave të përgjithshme	1,491,242.56 €	1,878,780.76 €
#	II- SHPENZIMET			
1	C	9. Paga dhe medijtje	990,800.34	1,129,864.98
2		10. Sigurimet shendetsores	-	30,600.00
3		11. Pagat dhe kontribute Bordi	46,993.83	53,589.38
4		12. Kontributet pensionale 5% nga Punëdhënësi	0.00 €	60,702.72 €
		Total Shpenzimet Pagave	1,037,794.17 €	1,274,757.08 €
#	Shpenzimet tjera Operative			
1	C	13. Shërbimi i trainimit të stafit	350.00 €	5,000.00 €
2		14. Shpenzimet e internetit	1,050.00 €	1,014.00 €
3		15. Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare	0.00 €	6,000.00 €
4		16. Shpenzimet e mirmbajtjes dhe digitalizimit të laurave	15,389.12 €	11,185.00 €
5		17. Shpenzimet e hostimit të Web	586.08 €	430.00 €
6		18. Shpenzimet e gypave për laura	0.00 €	510.00 €
7		19. Shpenzimet të kanaletave për kablo elektrike, të internetit dhe telefonit	0.00 €	400.00 €
8		20. Shpenzimi i kalibrimin të arkave fiskale	361.02 €	800.00 €
9		21. Shpenzimet e derivateve	2,000.00 €	4,000.00 €

10	22.Shpenzimet e mirembajtes të vetures - Gomat dimerore dhe Verore	0.00 €	480.00 €
11	23.shpenzimet për materialet hargjuese sanitare	1,805.00 €	2,460.00 €
12	24.Shpenzimet me furnizim me material administrativ(Leter, Rexhistrator, Stikera, Lapsa Kimik ,Municion Helika,Helika, Toner, Marker, File për dosje Barcod per asete, etj	3,500.00 €	5,000.00 €
13	25.Shpenzimet e furnizimit me uniforma verore për punëtores te ndërmarrjes	4,900.00 €	6,000.00 €
14	26.Shpenzimet e furnizimit me uniforma dimërore për punëtores te ndërmarrjes	4,900.00 €	9,000.00 €
15	27.Shpenzimet për furnizim me perde për zyre	0.00 €	1,000.00 €
16	28. Shpenzimi për kontrollin I rezistences se togezimit dhe rrufepritësit,	1,001.00 €	500.00 €
17	29.Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e vetures	600.00 €	600.00 €
18	30. Shpenzimet D.D.D	950.00 €	1,000.00 €
19	31.Shpenzimet e shërbimit të telefonisë mobile	1,326.98 €	1,980.00 €
20	32.Shpenzimet e shërbimit të telefonisë Fikse	982.35 €	1,500.00 €
21	33.Shpenzimet e shërbimit të transportit me Taxi	419.89 €	500.00 €
22	34.Shpenzimet për përkthime, nga dhe në Gjuhet Serbo-Kroate dhe Angleze	980.00 €	960.00 €
23	35.Shpenzimet për detyrimet kontingjente (rastet gjyqësore)	2,950.00 €	25,000.00 €
24	36.Shpenzimet e mbulimit të shtyllave në holl për reklama	0.00 €	3,000.00 €
25	37.Shpenzimet e rekreacioni dhe të ekskurzioni për puntorët	5,500.00 €	6,000.00 €
26	38. Shpenzimet e organizimit të darkës për fundvit për punëtores	3,200.00 €	4,000.00 €
27	39.Shpenzimet për kontrolla sistematike shëndetsore	0.00 €	6,000.00 €
28	40.Shpenzimet e furnizimit dhe montimit të sinjalistikes horizontale dhe vertikale	0.00 €	3,500.00 €
29	41.Shpenzimet për Renovim të sporteleve		5,000.00 €
30	42.Shpenzimet për çeshme dekorative të fontanës		600.00 €
31	43.Shpenzimet e servisimit të gjeneratorit		120.00 €
32	44.Shpenzimet e grumbullimit të mbeturinave	18,748.13 €	19,500.00 €
33	45.Shpenzimet për mbjelljen e drunjeve dekorativ dhe luleve sezonale dhe shumevjeqare		7,000.00 €
34	46.Shpenzimet e furnizimit me ngjyra për lyerjen dhe riparimi i stacionit	1,200.00 €	3,000.00 €
35	47.Shpenzimet për vendosjen e tri (3) oreve në holl dhe perona		500.00 €
36	48. shpenzimet për programin softverik të kontabilitetit	1,634.90 €	5,000.00 €
37	49.Shpenzimi I çertifikimit të pasqyrave financiare 2025		900.00 €
38	50.Shpenzimet e rrymes	16,523.45 €	23,600.00 €
39	51.Shpenzimet për uj dhe kanalizim	6,981.07 €	7,000.00 €

40	52.Shpenzimet për uj pije për staf dhe mysafir (Bidon dhe shishe)	1,001.00 €	2,160.00 €
41	53.Vleresimi per kenaqesine e konsumatoreve	1,050.00 €	1,000.00 €
42	54.Shpenzimet e projektimit ndertimor dhe të arkitekture	0.00 €	12,000.00 €
43	55.Shpenzimet e mbikqyrjes se projektit ndertimor	0.00 €	6,500.00 €
44	56.Shpenzimet tjera te paparashikuara - per blere te shpejta ditore	2,050.00 €	2,050.00 €
45	57.Shpenzimet tjera te paparashikuara emergjente	9,900.00 €	18,450.00 €
46	59. Servisimit dhe kontrollimin e aparateve për shuarje të zjarrit		500.00 €
47	60. Mbikqyrjen e hidrantëve	6,000.00	500.00 €
48	61.Hostimi i emailave		310.00 €
49	62. Përmisimi i sistemit softwerik per sistemin digital		5,000.00 €
50	63.Shpenzimet e reprezentacionit		10,150.00 €
51	64. Shpenzimet Per riparimin e dyerve ne Holl	2,500.00	-
52	65. Sherbimi I internetit (Beck up)	193.08	
53	66.Sherbimi I printimit dhe fotokojes	1,200.00	
54	67.Furnizimi me Motokultivator	4,500.00	
55	68.Pagat Percjellese	2,000.00	
56	69.Renovimi I Fasades-Lyerja e objektit pjesa e jashtme	12,900.00	
57	70.Renovimi I Fasades-Holli I Brendshem		
58	71. Makin per kostije te murit te gjalle	250.00	
59	72. Trimer per Preje te barit	450.00	
60	73. Kositese te barit	350.00	
61	74. Renovimi I sporteleve	4,425.00	
62	75. Lyerja e Peronave	2,500.00	
63	76.Lyerja dhe Riparimi I rrethojave	3,200.00	
64	77. Riparimi I asfaltit te demtuar	9,900.00	
65	78. Shpenzimi I printimit dhe fotokopjes	950.00	
66	79. Mbjellja e Drunjeve	9,500.00	
67	80. Shpenzimet per Parketing	5,000.00	
68	81. Renovimi I Taoletit publik te ndermajjes	20,000.00	
69	82. Rivlersimi I pronave dhe asetete te luajtshme	2,500.00	
70	83. Angazhimi I Ekspertit per Provizionim te borxhit	4,500.00	
71	84. Total Investimet	80,400.00	

72		Total Shpenzimet Operative	285,058.07 €	238,658.99 €
#	D	II Total Shpenzimet	1,322,852.24 €	1,513,416.07 €
1		III. Fitimi operativ para Zhvlerësimit (Ç-D)	168,390.32 €	365,364.69 €
2	DH	IV. Amortizimi-Shpenzimet e zhvlerësimit	21,318.44 €	21,318.44 €
3		V. Fitimi/Humbja para të Tatimit(III-IV)	147,071.88	344,046.25
#	Rekapitulim i Rrjedhës së Keshit			
1		Saldo Fillestare 01.01.2026		1,150,000.00 €
2		Total Te hyrat		1,878,780.76 €
3		Pagat		-1,274,757.08 €
4		Shpenzimet Administrative dhe Operative		-238,658.99 €
5		Investimet		-436,150.00 €
6		Paraja në fund te vitit		1,079,214.69 €

11. Anexi 2 Tabela e pagave për vitin 2026

#	Pozita	Totali vjetor i pages
1	Udhëheqës i Kontabilitetit	€ 10,943.40
2	Likuidator i dokumenteve financiare	€ 8,207.55
3	Biletar	€ 7,751.51
4	Asistent i Z-PZHK	€ 8,207.55
5	Kontrollor i Sistemit dhe financave	€ 9,119.50
6	Faturist	€ 9,119.50
7	Biletar	€ 7,751.51
8	Administrator për evidence dhe Udhëheqje të mjeteve themelore	€ 10,031.45
9	Nënpunes në garderobe	€ 7,295.60
10	Biletar	€ 7,751.51
11	Zyrtar i Kontrollës së arkave fiskale dhe z-raporteve	€ 10,487.49
12	Biletar	€ 7,751.51
13	Biletar	€ 7,751.51
14	Nënpunës në Informata fonike dhe vizuele	€ 7,295.60
15	Dispeçer i peronave	€ 8,663.59
16	Punëtor në mirëmbajtje të Objekteve dhe Aseteve	€ 8,207.55
17	Zyrtar përgjegjës i Sigurimit	€ 10,031.45
18	Dispeçer i peronave	€ 8,663.59
19	Mirëmbajtës i Higjienës dhe Hapësirave Gjellbruese	€ 6,383.65
20	Biletar	€ 7,751.51

21	Asistent i Zyrës Ligjore	€	8,207.55
22	Drejtor i Shërbimeve te Përbashketa	€	11,855.35
23	Arkatar	€	9,119.50
24	Zyrtar për mbarvajtje te procesit te punes	€	9,119.50
25	Dispeçer i peronave	€	8,663.59
26	Zyrtar për marrdhenie me klient	€	10,943.40
27	Asistente administrativ i KE	€	8,207.55
28	Sigurim i Administrates	€	7,751.51
29	Biletar	€	7,751.51
30	Punëtor i sigurimit	€	7,295.60
31	Zyrtar i Burimev Njerezore	€	10,943.40
32	Arkatar	€	9,119.50
33	Mirëmbajtës i Higjienës dhe Hapsirave Gjelberuese	€	6,383.65
34	Zyrtar Certifikues I dokumenteve financiare	€	10,487.49
35	Depoist	€	8,207.55
36	Teknik I IT	€	9,119.50
37	Biletar	€	7,751.51
38	Nënpunës në Informata Fonike dhe Vizuele	€	7,295.60
39	Kontiste	€	10,031.45
40	Biletar	€	9,119.50
41	Punëtor i sigurimit	€	7,295.60
42	Punëtor i sigurimit	€	7,295.60
43	Biletar	€	7,751.51
44	Protokollist	€	9,119.50
45	Dispeçer i peronave	€	8,663.59
46	Udhëheqes i Shërbimit Teknik dhe të Mirëmbajtjes	€	10,943.40
47	Dispeçer i peronave	€	8,663.59
48	Zyrtar pergjegjes i prokurmit	€	11,399.44
49	Zyrtar i Sistemit të Digjitalizimit dhe TI-së	€	10,031.45
50	Mirëmbajtës i Higjienës dhe Hapësirave Gjelbruese	€	6,383.65
51	Biletar	€	7,751.51
52	Zyrtar e sherbimit te thesarit	€	10,031.45
53	Udheheqes i Arkave dhe Përlllogaritës i Pagave	€	10,487.49
54	Mirëmbajtës i Higjienës dhe Hapsirave Gjelberuese	€	6,383.65
55	Punëtor i Sigurimit	€	7,295.60
56	Vozitës dhe Logjistike	€	8,207.55
57	Biletar	€	7,751.51
58	Biletar	€	7,751.51
59	Zyrtar për Marketingdhe Shitje	€	10,943.40

60	Resepsionist	€	7,295.60
61	Bashkpunëtor i Zyrtarit të Burimeve Njerëzore	€	10,031.45
62	Regjistruar dhe Egzekutues i Pagesave	€	10,943.40
63	Zyrtar Ligjor	€	10,943.40
64	Biletar	€	7,751.51
65	Biletar	€	7,751.51
66	Zyrtar i Prokurimit	€	10,031.45
67	Zyrtar për Planifikim Zhvillim dhe Koordinim	€	10,943.40
68	Asistent i ZMPP	€	8,207.55
69	Biletar	€	7,751.51
70	Koordinator i Ndërrimi	€	10,031.45
71	Koordinator i Ndërrimi	€	10,031.45
72	Biletar	€	7,751.51
73	Arkivist	€	8,207.55
74	Biletar	€	7,751.51
75	Arkatar	€	9,119.50
76	Biletar	€	7,751.51
77	Mbikqyrës i CCTV	€	8,207.55
78	Biletar	€	7,751.51
79	Nëpunës në Informata fonike dhe vizuale	€	7,295.60
80	Punëtor në Mirëmbajtje të Objekteve dhe Aseteve	€	8,207.55
81	Operator manual i Biletave	€	8,207.55
82	Mirëmbajtës i Higjienës dhe Hapësirave Gjelbruese	€	6,383.65
83	Ndihmës Koordinator i Shërb. teknik	€	8,207.55
84	Nëpunës në garderobe	€	7,295.60
85	Udhëheqës i shërbimit të transportit	€	11,399.44
86	Drejtor i Administratës	€	11,855.35
87	Arkatar	€	9,119.50
88	Zyrtar për Marrëdhënie me Publikun	€	10,487.49
89	Koordinator i ndërrimi	€	9,119.50
90	Dispeçer i peronave	€	8,663.59
91	Mirëmbajtës i Higjienës dhe Hapësirave Gjelbruese	€	6,383.65
92	Mirëmbajtës i Higjienës dhe Hapësirave Gjelbruese	€	6,383.65
93	Zyrtar për Shëndet dhe Siguri në Punë	€	10,031.45
94	Zyrtar i Transportit	€	10,943.40
95	Likuidatore	€	7,137.00
96	Nëpunës në garderobë	€	7,295.60
97	Koordinator i Ndërrimi	€	10,031.45
98	Drejtor i Operativës	€	11,855.35


99	Sekretar Korporativ	€	12,012.00
100	Zyrtar i Auditimit të Brendshëm ZAB	€	12,012.00
101	ZKFTH	€	12,012.00
102	Ud.Kryeshef Ekzekutiv	€	17,875.00
103	Bonuset shtese	€	3,000.00
Total paga pa kontribute për punëtor		€	912,160.98
1	Stazhi	€	69,600.00
2	Shujta 102*5.5*276	€	148,104.00
3	Sigurimi i Punetoreve	€	30,600.00
4	Kontributet Pensionale	€	58,023.25
T	Totali i kontributeve dhe sigurimeve për punëtor	€	306,327.25
Totali pagave dhe kontributeve për punëtorët		€	1,218,488.23
1	Kryesues i Komitetit të Auditimit	€	8,666.58
2	Kryesues i Bordit Drejtoreve	€	9,046.83
3	Anëtar i BD-së	€	8,362.51
4	Anëtar i BD-së	€	8,362.51
5	Aksionar	€	6,383.65
6	Aksionar	€	6,383.65
7	Aksionar	€	6,383.65
8	Kontribute pensionale	€	2,679.47
T	Totali pagesave për BD dhe Aksionar	€	56,268.85
Totali i pagesave për paga		€	1,274,757.08

Hartuesi i planit
UD i Kryeshefit Ekzekutiv
NPL Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë
Veton R. PRELVUKAJ



Miratuesi i planit
Kryesues i Bordit të Drejtoreve
NPL Stacioni i Autobusëve sh.a Prishtinë
Pajtim DEMAJ

12. Anexi 3 organogrami





NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
G.P "AUTOBUSKA STANICA" A. D.
MPE "BUS STATION" J. S.

Nr. 02/3528/1 Data 22.12 2025
No. 25
PRISHTINË/A



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
G.P "AUTOBUSKA STANICA" A. D. PRISHTINË
MPE "BUS STATION" J. S. PRISHTINË


Bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 04/L – 111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L - 087 për ndërmarrjet publike, dhe bazuar në shqyrtimin e Plan Biznesit për vitin 2026 ne mbledhjen Bordit të Drejtorve të mbajtur me 31.10.2025, Bordi i Drejtorëve pas votimit të zhvilluar përmes komunikimit elektronik (e-mailit zyrtar) me dt.12.12.2025 me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

(Miratimi i Planit të Biznesit për vitin afarist 2026)

- I. **MIRATOHET** Plani Biznesi për vitin afarist 2026 i NPL Stacionit të Autobusëve sh.a Prishtinë siq është paraqitur dhe votuar nga Bordi i Drejtorëve
- II. Obligohet Menaxhmenti i ndermarrjes per zbatimin e ketij Plan Biznes dhe fillon te impletohet nga data **01.01.2026**
- III. Plani i biznesit i miratuar sipas këtij vendimi është dokument publik dhe i njëjti publikohet në Web Faqen zyrtare të NPL Stacionit të Autobusëve sh.a Prishtinë.
- IV. Ndryshim dhe rishikimi i planit të biznesit të miratuar sipas këtij vendimi bëhet vetem në bazë të kushteve ligjore sipas legjislacionit në fuqi.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit

Kryesuesi i Bordit
Pajtim Denaj



T'i dorëzohet:

1x1.UD Kryeshefit Ekzekutiv,
1x1.ZKFTH-së;
1x1.Sekretarit,
1x1.Arkivit.

Prishtinë 2025